



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 30.09.2020)

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:00 dhe mbaroi në orën 11:11.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|-----------------------------|--------------------------|
| <i>1. Naureda Llagami</i> | <i>(kryetare)</i> |
| <i>2. Maksim Qoku</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>3. Medi Bici</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>4. Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>5. Brunilda Kadi</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>6. Dritan Hallunaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>7. Ilir Toska</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>8. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>9. Brikena Ukperaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>10. Marçela Shehu</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>11. Erjon Muharremaj</i> | <i>(anëtar)</i> |

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*

3. *Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Aleksandër Çavo, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
5. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
6. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
7. *Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi dërgimin e emrave të kandidatëve që plotësojnë kushtet për t’u komanduar në pozicionin e ndihmësmagjistratit pranë Gjykatën e Lartë”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Naureda Llagami: Atëherë, përshëndetje!

Po fillojmë mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor të datës 30 shtator 2020.

Siç jeni në dijeni sot në rendin e ditës, për shkak të urgjencës kemi një çështje e cila ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për dërgimin e emrave të kandidatëve që plotësojnë kushtet për t’u komanduar në pozicionin e ndihmësmagjistratit pranë Gjykatën e Lartë”. Ky projekt-akt është propozuar Këshillit, mbledhjes plenare nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, dhe do të relatohet nga zoti Toro.

Alban Toro: Faleminderit!

Më herët ky Këshill, me vendimet nr. 342, nr. 344, nr. 343 dhe nr. 339, datë 24.09.2020 ka miratuar opinionet në lidhje me komandimin e gjyqtarëve {...} – {...} duke vlerësuar se komandimi i tyre pranë Gjykatës së Lartë ishte në përputhje me interesat e lartë të gjykatës, pra nuk cenon interesat e gjykatës nga ata vijnë.

Më pas ligji na përcakton, neni 53, por edhe vendimi 258, 23.07.2020, na përcakton që Këshilli do duhet të vlerësojë plotësimin nga ana e këtyre gjyqtarëve të kushteve të komandimit, të cilat po jua pasqyroj thjesht për rifreskim, janë:

“a) Komandimi nuk duhet të bjerë ndesh me interesat e lartë të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin e gjyqtarit;

b) Kandidati nuk duhet të jetë në një pozicion me mandat të kufizuar;

- c) Kandidati nuk duhet të jetë i komanduar;
- ç) Kandidati, që ka qenë i komanduar më parë:
 - i) duhet të ketë shërbyer jo më pak se pesë vjet si gjyqtar pas përfundimit të periudhës së mëparshme të komandimit;
 - ii) nuk duhet të ketë kaluar kohëzgjatjen maksimale të komandimit prej më shumë se dhjetë vjet gjatë gjithë periudhës së ushtrimit të detyrës;
- d) Kandidati të mos ketë masë disiplinore në fuqi”.

Nga verifikimi i të dhënave që janë administruar nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit rezulton se:

Gjyqtarja {...}, fillimin në detyrë e ka me sipas Dekretin nr.5992, datë 07.1.2009 të Presidentit të Republikës, nëpërmjet të cilit emërohet për të kryer stazhin profesional në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, dhe me Dekretin nr.6623, datë 25.06.2010 të Presidentit të Republikës, është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë. Vjetërsia në detyrë 11 vjet. Znj. {...} nuk rezulton të ketë masë disiplinore në fuqi.

Gjyqtarja Lorena Çabej fillimin në detyrë e ka me Vendim nr. 135, datë 19.07.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor ku është emëruar gjyqtare dhe me Vendim KLGJ nr.145, datë 30.07.2019 është caktuar në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, funksion që kryen dhe aktualisht. Vjetërsia në detyrë 1 vit. Znj. {...} nuk ka masë disiplinore në fuqi.

Gjyqtarja {...} fillimin në detyrë e ka me Vendim nr. 8, datë 09.01.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor ku është emëruar gjyqtare dhe me Vendim KLGJ nr.48, datë 29.01.2020 është caktuar në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, funksion që kryen dhe aktualisht. Vjetërsia në detyrë 9 muaj. Nuk rezulton të ketë masë disiplinore në fuqi.

Gjyqtarja {...}, fillimin në detyrë e ka me vendimin nr.1, datë 09.01.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ku është emëruar gjyqtare. Me vendimin nr.42, datë 29.01.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor është caktuar në pozicion për të ushtruar funksionin e gjyqtares pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, ku vijon të ushtrojë funksionin dhe aktualisht. Edhe kjo gjyqtare nuk rezulton të ketë masë disiplinore në fuqi.

Pra nga tërësia e të dhënave rezulton që për të gjithë kandidatët {...} – {...} rezulton se: Komandimi i tyre nuk vjen ndesh me interesat e lartë të gjykatës ku ushtrojnë funksionin e gjyqtarit; Kandidatët nuk janë në një pozicion me mandat të kufizuar; Kandidatët nuk kanë qenë dhe nuk janë të komanduar; Kandidatët nuk kanë asnjë masë disiplinore në fuqi.

Në këto kushte Komisioni ju propozon të miratoni projektvendimin, në dispozitivin e të cilit do të gjeni... në fakt kemi përgatitur dy variante dhe varianti më i fundit që është përgatitur sot, që në përmbajtje nuk ndryshon, thjesht në mënyrën e pasqyrimin të lëndës që ka brenda. Gjithsesi unë po i lexoj të dy variantet, për t'ia lënë Këshillit të zgjedhë draftin më të mirë dhe të saktë.

Nëse me anë të e-mailit/postës elektronike ju kemi dërguar këtë variant:

1. Verifikimin e plotësimit e kushteve të komandimit në pozicionin e ndihmësmagjistratit pranë Gjykatën e Lartë, për kandidatët:

- 1) Znj. {...}, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë;
- 2) Znj. {...}, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë;
- 3) Znj. {...}, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë;
- 4) Znj. {...}, gjyqtare në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Korçë.

2. Dërgimin Gjykatës së Lartë të emrave të kandidatëve që plotësojnë kushtet e komandimit në pozicionin e ndihmësmagjistratit, së bashku me dokumentacionin e paraqitur nga ata në lidhje me kriteret preferenciale të komandimit, si dhe të dhënat mbi përvojën profesionale të tyre.

3. Një kopje e vendimit iu njoftohet kandidatëve znj. {...} – {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të ligjit nr. 115/2016.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Ky është varianti që ju është dërguar me postën elektronike.

Ndërkohë, duke u munduar ta saktësojmë akoma më tej, është propozuar një variant i ri me të njëjtën përmbajtje, por në mënyrë tjetër pasqyrimi. Në dispozitivin e këtij varianti do të gjeni:

1. Dërgimin Gjykatës së Lartë, të emrave të kandidatëve që plotësojnë kushtet e komandimit në pozicionin e ndihmësmagjistratit, së bashku me dokumentacionin e paraqitur

nga ata në lidhje me kriteret preferenciale të komandimit, si dhe të dhënat mbi përvojën profesionale të tyre, si më poshtë:

1. Znj. {...}, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë;
2. Znj. {...}, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë;
3. Znj. {...}, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë;
4. Znj. {...}, gjyqtare në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Korçë.

2. Një kopje e vendimit iu njoftohet kandidatëve znj. {...} – {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të ligjit nr. 115/2016, me ndryshime.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Pra thjesht është një sintetizim në këtë variant. Na u duk më i saktë. Gjithsesi vendosni ju. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toro!

Kemi ndonjë diskutim lidhur me variantet? Në qoftë se ne biem dakord e hedhim variantin e dytë, të cilin Komisioni e konsideron më të përshtatshëm?

Marçela Shehu: Po, dakord. Të hedhim në votim këtë të dytin.

Naureda Llagami: Meqë ju keni reflektuar dhe mendoni që ky është më i përshtatshëm.

Atëherë, hedhim variantin e dytë të propozuar nga relatori dhe Komisioni.

Brunilda Kadi: Kryetare më fal.

Më fal një sekondë.

Ka kuptim që të hidhen të gjithë emrat bashkë? Sepse, pavarësisht se ndoshta ata janë në të njëjtat kushte, akti duhet të jetë individual edhe njëri mund t'i plotësojë, tjetri mund të mos i plotësojë dhe dikush nga anëtarët mund të votojë ndryshe. Kam përshtypjen që nga ana formale dhe logjike s'mund të votohen bashkë ato, sipas projektit. Ndoshta duhet t'i hidhni një nga një në votim.

Ilir Toska: Me leje!

Naureda Llagami: Po, zoti Toska!

Ilir Toska: Atëherë, nëse ka ndonjë nga anëtarët që ka mendim ndryshe për ndonjë nga kandidatët, duhet të votojë pjesërisht kundër dhe është kundër për atë kandidat. Në fakt ky vendim ka të bëjë me dërgimin Gjykatës së Lartë të kandidatëve që plotësojnë kushtet e kandidimit. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, vijojmë me hedhjen në votim të variantit të dytë të propozuar nga relatori dhe pranuar nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Duke qenë se unë për dy nga kandidatët në fazën e parë kam votuar “kundër”, pasi kam vlerësuar që cenohet funksionaliteti i gjykatës, por Këshilli me shumicë votash votoi të kundërtën e kësaj, pra votoi që nuk e cenon funksionalitetin, në këtë fazë të dytë unë jam detyruar të votoj dhe për këtë arsye që bëhet ky vendim, nuk kam kundërshtim dhe votoj “pro”. E zgjata kaq për të sqaruar lidhjen me fazën e parë. Faleminderit!

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Dërgimin Gjykatës së Lartë, të emrave të kandidatëve që plotësojnë kushtet e komandimit në pozicionin e ndihmësmagjistratit, së bashku me dokumentacionin e paraqitur nga ata në lidhje me kriteret preferenciale të komandimit, si dhe të dhënat mbi përvojën profesionale të tyre, si më poshtë:

1. Znj. {...}, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë;
2. Znj. {...}, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë;

3. Znj. {...}, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë;

4. Znj. {...}, gjyqtare në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Korçë.

2. Një kopje e vendimit iu njoftohet kandidatëve {...} – {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Atëherë, me kaq po e mbyllim mbledhjen.

Në fakt, kisha vetëm një çështje për të diskutuar.

Duke qenë që nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës më është relatuar që nesër mund të jenë gati për të bërë delegimet të cilat janë për çështje të ngutshme, në momentin që nga ana e Komisionit më vihet në dispozicion relacioni, do ju caktoj për një mbledhje nesër, duke qenë se janë mbledhur shumë delegime dhe duhet që t’i bëjmë.

Atëherë, nëse s’kemi gjë tjetër, mirupafshim dhe ditë të mbarë!

* * *

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor